

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E REGJISTRIMIT DHE PRANIMIT TE NXENËSVE

Proçesi i Zgjedhjes së Shkollës Viti 2015-2016

Çfarë duhet bërë nga Nxënësit jashtë Drejtorisë Arsimore

Faza Përgatitore



- ✓ Rishikoni rekordet mësimore më të fundit të nxënësit. Kjo përfshin, por nuk kufizohet me notat, frekuentimin, sjelljen dhe rezultatet e testeve të standardizuara.
- ✓ Kërkoni për shkollat ku nxënësi mund të jetë i interesuar për të aplikuar (vizitoni panairt e shkollave, kërkoni në internet, planifikoni vizitë në shkollë, përdorni sa më tepër burime të mundëshme për njohjen e shkollave).
- ✓ Për shkollat me kritere pranimi, (Pranim Special, Shkollat ose Programet nga i Gjithë Qyteti) sigurohuni të krahasoni rezultatet e nxënësit, me kriteret e pranimit.

Dërgimi i Aplikimit

- ✓ Shkoni në schoolselect.philasd.org. (Mos shtypni www në këtë ueb adresë)
- ✓ Klikoni në butonin blu, që thotë “Nuk jam nxënës i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, APLIKO TANI!” Ky është butoni për nxënësit që aktualisht nuk janë nxënës të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Ky është buton edhe për familjet e nxënësve Pre-K, që aplikojnë për klasa kopështi për Shtatorin e 2016, në shkolla jashtë zonës së tyre të banimit.
- ✓ Plotësoni aplikimin. Nxënësit mund të zgjedhin deri në pesë shkolla të Filadelfias.
- ✓ Sigurohuni që adresa juaj e emailit është e saktë. Kjo është shumë e rëndësishme! Drejtorja Arsimore do të dërgojë në këtë email të gjitha çeshtjet që lidhen me aplikimin tuaj (vendimi për pranim, njoftime, përditësime, etj.), pasi aplikimi të jetë kryer.
- ✓ **KUJTESË:** Me konfirmimin e aplikimit, **ai nuk mund të ndryshohet**. Ju lutemi sigurohuni për saktësinë e të dhënave përpara se të shtypni butonin e konfirmimit.
- ✓ Në rast se do të kryhen aplikime shtesë për të njëjtin nxënës, Drejtorja Arsimore do të pranojë si të mirëqenë aplikimin e **fundit** të dërguar. **Të gjitha** aplikimet e mëparëshme do të fshihen.



Dërgimi i Rekordeve Mësimore dhe Dokumentave Plotësuese

Nxënësit jashtë Drejtorisë Arsimore të Filadelfias **duhet**

të dërgojnë dokumentat e plota të vitit mësimor para-ardhës në të **gjitha** shkollat ku do të aplikojnë. Kjo përfshin, por nuk kufizohet me:

- ✓ Dëftesën e fundit të shkollës
- ✓ Rezultatet më të fundit të testit të standardizuar
- ✓ Të dhënat më të fundit të frekuentimit
- ✓ Të dhënat më të fundit të sjelljes
- ✓ Shëmbuj të eseve, ose shkrimeve, në shkollat që kërkohen
- ✓ Letra rekomandimi, aty ku kërkohen
- ✓ Në rast se fëmija juaj ka një plan IEP, 504Plan, ose merr shërbime të ESOL, ju lutemi kontaktoni me këshilltarin tuaj të shkollës dhe diskutoni rreth Proçesit të Mbrojtjes LeGare.

KUJTESË! Të gjithë aplikantët duhet të aplikojnë online **DHE** të dërgojnë të dhënat mësimore në secilën shkollë, që ka kërkesa për pranim. **Aplikantët që nuk i plotësojnë të dyja konditat, nuk do të shqyrtohen në proçesin e pranimit.**

Në vazhdimësi

- ✓ Kontaktoni shkollat e aplikimit tuaj, për datat dhe orën e intervistave, dëgjimeve dhe vizitave të hapura.

?Pyetje?

Kontaktoni Zyrën e Regjistrimit dhe Pranimit të Nxënësit në:
schoolselect@philasd.org, ose telefononi 215-400-4290.